




Funded by
the European Union



NDOTJA PLASTIKE NË BASENIN E LUMIT ISHËM

ANALIZË E TË DHËNAVE NGA MONITORIMI
I MBETJEVE DETARE DHE REKOMANDIME PËR
MASA POLITIKE DHE INSTITUCIONALE

MARS, 2026



Përgatitur nga	ESDO - Environmental and Sustainable Development Office
Autorë	Ornela Shoshi - Eksperte e Lartë Mjedis Emanuela Arifi - Eksperte Mjedis Greta Malaj - Specialiste Mjedis
Kontribues	Arion Sauku - Menaxher Projekti Valbona Mazreku - Eksperte e Lartë Mjedis Kledisa Çela - Koordinatore Projekti Mevis Struga - Ekspert për Angazhimin e Aktorëve të Interesit dhe Marrëdhëniet me Publikun

Ky botim është prodhuar në kuadër të projektit RIVERCLEAN, i cili financohet nga Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri dhe zbatohet nga Milieukontakt Shqipëri dhe Instituti për Menaxhimin e Mjedisit dhe Territorit. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura janë vetëm ato të autorit(ëve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Bashkimit Evropian.



Tabela e Përmbajtjes

1. Hyrje	5
1.1 Qëllimi i dokumentit të politikave	5
1.2 Baseni i lumit Ishëm dhe mbetjet detare	5
1.3 Burimet e të dhënave dhe metodologjia e monitorimit	7
2. Gjetjet kryesore nga monitorimi i mbetjeve detare në Basenin e Lumit Ishëm	8
2.1 Zonat e monitorimit dhe fushatat e realizuara	8
2.1.1 Kepi i Rodonit (Baseni Ishëm)	10
2.1.2 Plazhi Hamallaj (Baseni Ishëm)	11
2.2 Kategoritë dominante të mbetjeve	15
2.3 Burimet e ndotjes plastike	15
2.3.1 Rrugët e transportit të mbetjeve plastike	15
2.3.2 Turizmi dhe rekreacioni bregdetar	16
2.3.3 Rrjedhja e mbetjeve urbane dhe rrjedhjet sipërfaqësore	16
2.3.4 Mangësitë në menaxhimin e mbetjeve	16
3. Kuadri i politikave për menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri dhe rëndësia për Basenin e Lumit Ishëm	16
3.1 Kuadri ligjor kombëtar për menaxhimin e mbetjeve	16
3.2 Kuadri strategjik i politikave	17
3.3 Përgjegjësitë institucionale për menaxhimin e mbetjeve	19
3.4 Mangësitë kryesore të zbatimit në Basenin e Lumit Ishëm	19
4. Rekomandime për politikën	20
4.1 Masat prioritare për reduktimin e ndotjes plastike në Basenin e Lumit Ishëm	22
4.2 Prioritetet e zbatimit	26
4.3 Mekanizmat e angazhimit të aktorëve të interesit	26
5. Përfundime	29

Lista e Figurave

Figure 1. Rezultatet e monitorimit për Kepin e Rodonit	11
Figure 2. Rezultatet e monitorimit për plazhin e Hamallajt	14

Lista e Tabelave

Tabela 1. Cilësia e ujit në basenet lumore gjatë periudhës 2018–2024	6
Tabela 2. Përmbledhje e të dhënave të monitorimit për Kepin e Rodonit	10
Tabela 3. Përmbledhje e të dhënave të monitorimit për plazhin e Hamallajt	13

Akronime

AKEM	– Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve
AKM	– Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AMORE-AL	– Projekti për Vlerësimin e Shkarkimeve të Ndotësve në Mbështetje të Menaxhimit të Baseneve Lumore në Shqipëri
BE	– Bashkimi Evropian
HoReCa	– Hotele, Restorante dhe Kafene/Katering
INSTAT	– Instituti i Statistikave
KE	– Komuniteti Evropian
OECD	– Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
UNECE	– Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën
VKM	– Vendim i Këshillit të Ministrave

1. Hyrje

1.1 Qëllimi i dokumentit të politikave

Ky dokument politikash synon të vlerësojë nivelin e zbatimit të politikave të menaxhimit të mbetjeve mbi bazën e informacionit të mbledhur në terren dhe të evidencave të monitorimit. Ai përkthen të dhënat e monitorimit të mbetjeve detare të realizuara në kuadër të projektit RiverClean në rekomandime të përdorshme për politikëbërjen, me qëllim përmirësimin e performancës së menaxhimit të mbetjeve në nivel kombëtar dhe vendor.

Dokumenti propozon një paketë masash që mund të ndërmerren nga bashkitë dhe institucionet përgjegjëse. Efektiviteti i këtyre masave mund të ndiqet në vijim përmes monitorimit të përsëritur të mbetjeve në plazhe dhe zona bregdetare.

Fokusi kryesor është ulja e kategorive më të shpeshta të mbetjeve plastike të identifikuara gjatë fushatave të monitorimit dhe rritja e efektivitetit të instrumenteve ekzistuese të menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri. Duke lidhur modelet e vëzhguara të mbetjeve me mangësitë në zbatimin e politikave, analiza ofron rekomandime të mbështetura në evidencë për forcimin e parandalimit, mbledhjes dhe riciklimit të mbetjeve plastike brenda basenit të lumit Ishëm.

Në nivel kombëtar, të dhënat e INSTAT për vitin 2023 tregojnë se 9.27% e mbetjeve bashkiake të gjeneruara në Shqipëri ishin mbetje plastike. Nga totali i mbetjeve bashkiake të menaxhuara, 76.49% u depozituan në landfille, 18.81% u ricikluan dhe 4.5% u përdorën për rikuperim energjie. Një pjesë e popullsisë mbetet ende jashtë shërbimit të rregullt të grumbullimit, çka rrit rrezikun që mbetjet të hidhen në mjedis ose të përfundojnë në trupat ujorë.

1.2 Baseni i lumit Ishëm dhe mbetjet detare

Baseni i lumit Ishëm mbulon një pjesë të rëndësishme të Shqipërisë qendrore dhe përfshin bashkitë Tiranë, Kamëz, Vorë, Krujë, Kurbin dhe Durrës. Performanca e menaxhimit të mbetjeve në këto bashki ndikon drejtpërdrejtë në sasinë e mbetjeve plastike që hyjnë në sistemin lumor dhe, dhe rrjedhimisht, në Detin Adriatik.

Baseni kombinon zona shumë të urbanizuara¹ me vendbanime periurbane në zgjerim të shpejtë, veçanërisht në zonën metropolitane të Tiranës. Për shkak se përfshin kryeqytetin dhe bashkitë përreth, baseni ka një përqendrim të lartë popullsie krahasuar me basenet e tjera lumore. Ky përqendrim gjeneron volume të konsiderueshme mbetjesh bashkiake dhe rrit rrezikun e depozitimit të plastikës në mjedis, veçanërisht aty ku sistemet e menaxhimit janë të cinguara ose joefektive.

Gjenerimi i mbetjeve në basen ndikohet jo vetëm nga numri i banorëve, por edhe nga zgjerimi urban, aktiviteti ekonomik dhe rritja e turizmit, kryesisht në zonat bregdetare gjatë periudhës së verës. Këto dinamika shtojnë volumin e ambalazheve, produkteve plastike një përdorimëshe dhe materialeve të tjera plastike në rrjedhat e mbetjeve bashkiake.

Për këtë arsye, funksionimi i sistemeve të menaxhimit të mbetjeve në të gjithë basenin është një tregues kryesor i sasisë së mbetjeve plastike që mund të hidhen në ujëra dhe të transportohen drejt zonave bregdetare.

¹ <https://www.instat.gov.al/sq/temat/treguesit-demografike-dhe-sociale/popullsia/>

Tabela 1 si më poshtë, paraqet statusin e cilësisë së ujit të baseneve lumore të Shqipërisë gjatë periudhës 2018–2024. Të dhënat janë marrë nga raporti i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit mbi gjendjen e mjedisit në Shqipëri, 2024. Ndër presionet që ndikojnë në cilësinë e ujit, ndotja plastike është një faktor i rëndësishëm kontribues, pasi ajo degradon ekosistemet ujore dhe ndikon negativisht në gjendjen e përgjithshme mjedisore të ujërave sipërfaqësore.

Tabela 1 - Cilësia e ujit në basenet lumore gjatë periudhës 2018–2024. Burimi: Raporti i Gjendjes së Mjedisit në Shqipëri, AKM, 2024

Year	Baseni lumor Drin Buna	Baseni lumor Ishëm Erzen	Baseni lumor Shkumbin	Baseni lumor Seman	Baseni lumor Vjosa	Baseni lumor Mat
2018	Klasa III	Klasa V	Klasa IV	Klasa V	Klasa II	Klasa III
2019	Klasa IV	Klasa V	Klasa III	Klasa V	Klasa III	Klasa II
2020	Klasa IV	Klasa V	Klasa III	Klasa V	Klasa II	Klasa III
2021	Klasa IV	Klasa V	Klasa II	Klasa V	Klasa II	Klasa III
2022	Klasa III	Klasa V	Klasa III	Klasa V	Klasa II	Klasa II
2023	Klasa IV	Klasa V	Klasa III	Klasa IV	Klasa II	Klasa II
2024	Klasa III	Klasa V	Klasa II	Klasa IV	Klasa II	Klasa II

Klasat e cilësisë së ujit tregojnë gjendjen e përgjithshme mjedisore të ujërave lumore, ku Klasa II reflekton cilësi të mirë, Klasa III cilësi të moderuar, Klasa IV cilësi të dobët dhe Klasa V cilësi shumë të dobët, që do të thotë se numrat më të lartë të klasës korrespondojnë me cilësi më të keqe të ujit dhe presion më të madh ndotjeje.

Praktikat e menaxhimit të mbetjeve të zbatuara në këto bashki luajnë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e sasisë së mbetjeve plastike që mund të hyjnë në sistemin lumor dhe të transportohen drejt zonave bregdetare.

Raporti për Gjendjen e Mjedisit ofron informacion mbi cilësinë e ujërave lumore, por aktualisht nuk përfshin një vlerësim të dedikuar mbi akumulimin e mbetjeve në lumenj dhe në zonat bregdetare. Për rrjedhojë, të dhënat mbi sasinë dhe përbërjen e mbetjeve plastike që arrijnë në lumenj dhe në zonat bregdetare mbeten të kufizuara. Kjo e rrit rëndësinë e të dhënave të monitorimit të RiverClean për analiza në nivel baseni.

Në nivel kombëtar, gjatë vitit 2024 në Shqipëri janë menaxhuar rreth 870,883.59 ton mbetje, krahasuar me 820,322 ton në vitin 2023.

Shërbimet e grumbullimit të mbetjeve janë zgjeruar gjatë viteve të fundit, kryesisht në zonat urbane. Megjithatë, sfida të rëndësishme mbeten ende të pranishme. Mbulimi me shërbim është përgjithësisht më i lartë në bashkitë urbane, si Tirana dhe Kamza, ndërsa zonat peri-urbane dhe rurale mund të përballen ende me mungesa apo ndërprerje të shërbimit. Këto boshllëqe rrisin mundësinë që mbetjet e pamenaxhuara të hidhen në mjedis dhe të përfundojnë në lumenj, përrenj dhe kanale kulluese.



Edhe performanca e riciklimit mbetet e kufizuar. Norma e riciklimit të mbetjeve bashkiake në Shqipëri vlerësohet në rreth 18–19%,² çka tregon se pjesa më e madhe e mbetjeve vazhdon të depozitohet në venddepozitime apo landfille, në vend që të rikuperohet si material i riciklueshëm.

Ndarja e mbetjeve bashkiake mbetet ende një sfidë në Shqipëri. Ndarja në burim e mbetjeve bashkiake dhe infrastruktura përkatëse janë pothuajse të papranishme, pavarësisht detyrimeve ligjore ekzistuese. Në vitin 2023, metoda kryesore e menaxhimit të mbetjeve bashkiake ishte depozitimi në landfill, me mbi 70% të totalit, një nivel dukshëm më i lartë krahasuar me Bashkimin Evropian, ku kjo përqindje është rreth 23%.³ Megjithatë, në disa qytete të Shqipërisë janë në zhvillim disa projekte pilot për të futur grumbullimin e diferencuar të mbetjeve, veçanërisht për letrën dhe kartonin, aluminin, plastikën dhe mbetjet organike.⁴

Mbetjet plastike përbëjnë një pjesë të rëndësishme të mbetjeve bashkiake, kryesisht përmes ambalazheve të ushqimeve dhe pijeve, ambalazheve të produkteve të konsumit dhe qeseve plastike. Ndarja e kufizuar në burim, kapacitetet e pamjaftueshme të riciklimit dhe praktikatat e hedhjes së paligjshme të mbetjeve rrisin mundësinë që mbetjet plastike t'i shpëtojnë sistemit formal të menaxhimit dhe të përfundojnë në mjedisin natyror.

Në Basenin e Lumit Ishëm, ndotja plastike lidhet kryesisht me tre burime kryesore:

- mbetjet shtëpiake dhe të konsumit, përfshirë ambalazhet, shishet dhe qeset plastike;
- rrjedhjet e mbetjeve nga bashkitë urbane me dendësi të lartë popullore;
- praktikatat e pamjaftueshme të grumbullimit dhe depozitimit të mbetjeve në zonat peri-urbane dhe rurale

Pasi çlirohen në mjedis, materialet plastike me peshë të lehtë mund të transportohen përmes rrjedhjeve sipërfaqësore, erës dhe rrjedhave lumore. Në këtë kontekst, Lumi Ishëm funksionon si një rrugë kryesore transporti për mbetjet me origjinë tokësore, duke përcjellë mbetjet plastike nga vendbanimet në brendësi të territorit drejt bregdetit të Adriatikut, ku ato grumbullohen në mjediset bregdetare dhe plazhe.

Për këtë arsye, monitorimi i mbetjeve detare përgjatë vijës bregdetare të Adriatikut është i rëndësishëm jo vetëm për identifikimin e shkallës dhe përbërjes së ndotjes, por edhe për orientimin e masave dhe politikave në pjesën e sipërme të basenit, si dhe për vlerësimin e efektivitetit të masave të menaxhimit të mbetjeve të zbatuara brenda Basenit të Lumit Ishëm.

1.3 Burimet e të dhënave dhe metodologjia e monitorimit

Analiza e politikave bazohet kryesisht në fushatat e monitorimit të mbetjeve detare të realizuara nga stafi i projektit RiverClean në plazhet e Kepit të Rodonit dhe Hamallajt gjatë vitit 2025. Monitorimi është kryer në përputhje me metodologji të standardizuara për vlerësimin e mbetjeve në plazhe, duke regjistruar sasinë dhe përbërjen e mbetjeve në segmente të përcaktuara të vijës bregdetare.

² <https://www.eea.europa.eu/en/europe-environment-2025/countries/albania/waste-generation>

³ https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/env_wasmun__custom_20727021/default/table

⁴ https://www.oecd.org/content/dam/oecd/en/publications/reports/2024/03/a-roadmap-towards-circular-economy-of-albania_0fd9c3a4/8c970fdc-en.pdf



Rezultatet e monitorimit tregojnë se produktet plastike njëpërdorimshe të konsumit dhe materialet e ambalazhimit dominojnë përbërjen e mbetjeve të regjistruara në të dyja zonat e monitorimit. Kategoritë më të shpeshta të evidentuara përfshijnë:

- Artikujt plastikë të lidhur me pijet përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të mbetjeve të evidentuara. Në Kepin e Rodonit, shishet plastike të pijeve dhe kapakët/tapat përbëjnë rreth 59% të të gjithë artikujve të regjistruar, ndërsa në plazhin e Hamallajt të njëjtat kategori përbëjnë rreth 39%.
- Fragmentet plastike, përfshirë materialet plastike të shkumëzuara dhe jo të shkumëzuara, përbëjnë gjithashtu një kategori të rëndësishme. Në Kepin e Rodonit, fragmentet e polistirenit të shkumëzuar përbëjnë rreth 20% të mbetjeve të regjistruara, ndërsa në plazhin e Hamallajt fragmentet plastike jo të shkumëzuara përfaqësojnë rreth 22.2%, dhe polistireni i shkumëzuar rreth 12.2%.
- Ambalazhet plastike të ushqimeve, si paketimet e patatinave dhe mbështjellëset e ëmbëlsirave, janë një tjetër kategori e përsëritur. Ato përbëjnë rreth 3.9% të totalit të mbetjeve në Kepin e Rodonit dhe 9.5% në plazhin e Hamallajt.
- Qeset plastike të blerjeve dhe qeset mbajtëse janë veçanërisht të rëndësishme në zonat e monitorimit të Basenit të Vjosës, ku ato shfaqen ndër artikujt plastikë njëpërdorimëshe më të dallueshme. Ndërkohë, në zonat e monitorimit të Basenit të Ishmit, kategoritë dominuese janë ambalazhet e pijeve dhe fragmentet plastike.

Prania e përsëritur e këtyre kategorive në fushatat e monitorimit përbën një nga gjetjet kryesore të raportit, pasi tregon se mbetjet plastike vazhdojnë të hyjnë në mënyrë të vazhdueshme në mjedisin bregdetar, dhe nuk lidhen vetëm me raste të izoluara ndotjeje. Kjo evidencë është veçanërisht e rëndësishme për identifikimin e rrjedhave prioritare të mbetjeve, si dhe për vlerësimin e masës në të cilën masat ekzistuese të menaxhimit të mbetjeve po arrijnë të parandalojnë rrjedhjen e tyre drejt mjedisit në Basenin e Lumit Ishëm.

2. Gjetjet kryesore nga monitorimi i mbetjeve detare në Basenin e Lumit Ishëm

2.1 Zonat e monitorimit dhe fushatat e realizuara

Monitorimi i mbetjeve detare u krye nga stafi i projektit RiverClean në dy zona bregdetare brenda Basenit të Lumit Ishëm:

- Kepi i Rodonit
- Plazhi Hamallaj

Gjatë çdo fushate monitorimi u regjistrua numri dhe lloji i mbetjeve të gjetura përgjatë një segmenti 100 metra të vijës bregdetare. Rezultatet tregojnë modele të qëndrueshme në përbërjen e mbetjeve në të dyja zonat e monitorimit.

**Zonat e monitorimit
në basenin e Ishmit**

Kepi i Rodonit
Baseni Ishëm

Hamallaj
Baseni Ishëm

Ishëm



2.1.1 Kepi i Rodonit (Baseni Ishëm)


Monitorimi i kryer në Kepin e Rodonit gjatë muajve korrik dhe dhjetor 2025 tregon se mbetjet detare dominohen nga plastikat njëpërdorimshe të lidhura me pijet, veçanërisht kapakët/tapat e pijeve plastike (420), shishet plastike të vogla (408), fragmentet e polistirenit (373) dhe shishet plastike të mëdha (272). Prania e konsiderueshme e kanaçeve të pijeve (177) dhe ambalazheve ushqimore (73) konfirmon më tej rëndësinë e ambalazheve të konsumit të përditshëm si një burim kryesor ndotjeje.

Numri më i lartë i mbetjeve i regjistruar në muajin dhjetor sugjeron akumulim të vazhdueshëm dhe transport të mbetjeve të lehta përmes Lumit Ishëm dhe rrymave bregdetare. Këto gjetje theksojnë nevojën për forcimin e menaxhimit të mbetjeve në pjesën e sipërme të basenit, përmirësimin e mbulimit me shërbim grumbullimi dhe ndërmarrjen e masave të synuara për të reduktuar rrjedhjen e ambalazheve plastike drejt lumit dhe mjedisit bregdetar.

Tabela 2. Përmbledhje e të dhënave të monitorimit për Kepin e Rodonit. Burimi: Përpunim i të dhënave të mbledhura gjatë aktiviteteve të monitorimit nga ETMI

Kategoritë e mbetjeve	28/07/2025	19/12/2025	Total 2 monitorimet
Kapakët plastike të shisheve të pijeve	122	298	420
Shishet plastike të pijeve ≤0.5 L	153	255	408
Fragmente të polistirenit të shkumëzuar 2.5-50cm	124	249	373
Shishet plastike të pijeve >0.5 L	132	140	272
Kanaçe metalike të pijeve	72	105	177
Paketime plastike të patatinave/mbështjellëse ëmbëlsirash	38	35	73
Gota dhe kapakë nga plastikë e fortë	11	28	39
Artikuj të tjerë prej druri të përpunuar 2.5 cm ≥ ≤ 50 cm	15	20	35
Këpucë & sandale (lëkurë/tekstile)	8	25	33
Ambalazhe plastike mjekësore/farmaceutike	5	27	32

Figura 1. Rezultatet e monitorimit për Kepin e Rodonit. Burimi: Përpunim i të dhënave të mbledhura gjatë aktiviteteve të monitorimit nga ETMI



Mbetjet e lidhura me pijet dominojnë qartësisht në zonën e Kepit të Rodonit, ku kapakët/tapat plastike, shishet plastike të vogla dhe shishet plastike të mëdha së bashku përbëjnë gati 59% të të gjithë artikujve të regjistruar.

Fragmentet e polistirenit të shkumëzuar përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme, rreth 20.0%, duke treguar fragmentimin e vazhdueshëm dhe qëndrueshmërinë e mbetjeve të lidhura me ambalazhet në mjedisin bregdetar.

2.1.2 Plazhi Hamallaj (Baseni Ishëm)

Rezultatet e kombinuara nga 8 fushatat e monitorimit të realizuara në plazhin e Hamallaj gjatë periudhës mars 2024 – nëntor 2025 tregojnë një model të qëndrueshëm dhe të qartë në përbërjen e mbetjeve bregdetare, të dominuar kryesisht nga materiale plastike të lidhura me përdorimin e përditshëm nga konsumatorët. Të dhënat tregojnë se Hamallaj funksionon si një zonë bregdetare rekreative me presion të lartë, ku akumulimi i mbetjeve ndikohet kryesisht nga burime me origjinë tokësore dhe nga prurje të përsëritura sezonale.

- Gjatë gjithë periudhës së monitorimit, fragmentet e plastikës jo të shkumëzuar me madhësi 2.5–50 cm përfaqësojnë kategorinë më të bollshme, me një total prej 740 artikujsh të regjistruar. Kjo kategori zakonisht përfshin pjesë të thyera të produkteve plastike të forta dhe të buta, si shishe, enë, pjesë ambalazhesh, artikuj plastikë familjarë dhe materiale të tjera plastike konsumi të degraduara. Prania e tyre e vazhdueshme në të gjitha fushatat sugjeron akumulim afatgjatë dhe fragmentim progresiv të objekteve më të mëdha plastike që janë tashmë të pranishme në mjedisin bregdetar.

- Mbetjet e lidhura me pijet përbëjnë komponentin e dytë kryesor të ndotjes. Shishet e vogla plastike të pijeve, me vëllim deri në 0.5 L, arrijnë në 522 artikuj, ndërsa shishet plastike më të mëdha, mbi 0.5 L, arrijnë në 288 artikuj.
- Përveç tyre, kapakët dhe tapat plastike të pijeve përbëjnë gjithsej 497 artikuj, duke konfirmuar ndikimin e lartë të modeleve të konsumit njëpërdorimësh.
- Fragmentet e polistirenit të shkumëzuar me madhësi 2.5–50 cm janë të përfaqësuara ndjeshëm, me 407 artikuj të regjistruar. Këto materiale zakonisht lidhen me ambalazhimin dhe izolimin, dhe kanë tendencë të copëzohen në pjesë më të vogla nën ndikimin e kushteve mjedisore, duke kontribuar në akumulimin e vazhdueshëm të mbetjeve të lehta përgjatë vijës bregdetare.
- Ambalazhet ushqimore, veçanërisht paketimet e patatinave dhe mbështjellëset e ëmbëlsirave, shfaqin gjithashtu një prani të konsiderueshme, me një total prej 315 artikujsh.
- Në mënyrë të ngjashme, gotat dhe kapakët prej plastike të fortë, me 235 artikuj të regjistruar, tregojnë se konsumi në vend është një nga faktorët kryesorë që nxit gjenerimin e mbetjeve.
- Kategori të tjera të rëndësishme përfshijnë kapakët dhe tapat plastike nga enët e produkteve kimike dhe detergjentëve, me 192 artikuj, shishet dhe enët plastike të produkteve të pastrimit, me 89 artikuj, si dhe mbetjet e lidhura me duhanin, si bishtat e cigareve, me 132 artikuj.


Rezultatet tregojnë se plazhi i Hamallajt karakterizohet nga një dominim i vazhdueshëm i mbetjeve plastike të konsumit, veçanërisht i ambalazheve të lidhura me pijet dhe materialeve të fragmentuara. Qëndrueshmëria e këtyre kategorive gjatë disa periudhave monitorimi sugjeron prurje të vazhdueshme të mbetjeve dhe largim të kufizuar natyror, duke çuar në akumulim afatgjatë në mjedisin bregdetar.

Tabela 3. Përmbledhje e të dhënave të monitorimit për plazhin e Hamallajt. Burimi: Përpunim i të dhënave të mbledhura gjatë aktiviteteve të monitorimit nga ETMI, në kuadër të projektit REMEDIES)⁵

Kategoritë e mbetjeve	17/03/2024	26/04/2024	26/07/2024	27/10/2024	26/01/2025	14/05/2025	25/07/2025	16/11/2025	Totali i akumuluar gjatë 8 fushatave
Fragmente të plastikës të fortë me madhësi 2.5-50cm	181	182	35	126	73	56	40	47	740
Shishet plastike të pijeve ≤0.5 L	134	45	56	79	40	68	27	73	522
Kapakët plastike të shisheve të pijeve	100	51	42	100	55	30	51	68	497
Fragmente të polistirenit të shkumëzuar 2.5-50cm	102	46	73	39	54	32	23	38	407
Paketime plastike të patatinave/mbështjellëse ëmbëlsirash	27	31	58	44	9	24	85	37	315
Shishet plastike të pijeve >0.5 L	96	23	41	31	18	24	21	34	288
Gota dhe kapakë nga plastikë e fortë	11	14	54	34	9	14	42	57	235
Kapakë dhe tapa plastike nga produkte kimike dhe detergjentë	9	32	6	87	11	15	15	17	192
Produkte duhani me filtra (bishta cigaresh me filtra)	8	1	43	28	5	2	38	7	132
Shishe dhe enë plastike të produkteve të pastrimit	38	8	5	12	9	11	-	6	89

⁵<https://remedies-for-ocean.eu/>

Figura 2. Rezultatet e monitorimit për plazhin e Hamallajt. Burimi: Përpunim i të dhënave të mbledhura gjatë aktiviteteve të monitorimit nga ETMI, në kuadër të projektit REMEDIES



2.2 Kategoritë dominante të mbetjeve

Rezultatet e monitorimit nga Kepi i Rodonit dhe plazhi i Hamallajt tregojnë një mbizotërim të qartë të mbetjeve me bazë plastike, me përqendrimet më të larta në kategoritë që lidhen me produktet njëpërdorimshe të konsumit. Artikujt më të rëndësishëm të regjistruar në të dyja zonat përfshijnë shishet e pijeve, kapakët dhe tapat, ambalazhet ushqimore dhe fragmentet plastike, duke treguar se ambalazhet e konsumit mbeten komponenti kryesor i mbetjeve bregdetare në zonat e ndikuara nga Baseni i Lumit Ishëm.

Një pjesë e konsiderueshme e mbetjeve të regjistruara përbëhet nga artikuj të lidhur me pijet, çka tregon ndikimin e fortë të konsumit gjatë lëvizjes, përdorimit rekreativ të zonave bregdetare dhe praktikave të pamjaftueshme të depozitimit të mbetjeve. Në të njëjtën kohë, prania e gjerë e fragmenteve plastike dhe polistirenit të shkumëzuar sugjeron copëzimin e vazhdueshëm të artikujve më të mëdhenj të mbetjeve që janë tashmë të pranishëm në mjedis. Ky proces fragmentimi rrit qëndrueshmërinë e mbetjeve në zonat bregdetare dhe kontribuon me kalimin e kohës në krijimin e grimcave më të vogla plastike.

Prania e përsëritur e ambalazheve ushqimore, gotave, kapakëve dhe materialeve të tjera të lehta të paketimit tregon më tej se mbetjet bregdetare janë të lidhura ngushtë me modelet e konsumit të përditshëm dhe me mbajtjen e pamjaftueshme të mbetjeve brenda sistemit të menaxhimit. Përveç kësaj, prania e disa artikujve të lidhur me përdorimin familjar dhe e mbetjeve të ndryshme sugjeron se një pjesë e ngarkesës së mbetjeve mund të ketë origjinë edhe nga vendbanimet në brendësi të territorit dhe të transportohet përmes sistemeve të kullimit dhe rrjedhave lumore.

Evidencat konfirmojnë se mbetjet detare në Basenin e Ishmit karakterizohen nga një grup i kufizuar, por i vazhdueshëm, artikujsh plastikë me frekuencë të lartë, të dominuar nga mbetjet e ambalazheve. Ky model thekson nevojën për masa të synuara parandaluese, të fokusuara te kategoritë më të zakonshme të mbetjeve dhe te rrugët kryesore përmes të cilave ato arrijnë në mjedisin bregdetar.

2.3 Burimet e ndotjes plastike

Përbërja e mbetjeve të regjistruara gjatë fushatave të monitorimit në Kepin e Rodonit dhe plazhin e Hamallajt tregon se ndotja plastike në zonat bregdetare të ndikuara nga Baseni i Lumit Ishëm vjen nga disa burime të ndërlidhura me origjinë tokësore. Këto burime lidhen kryesisht me gjenerimin e mbetjeve urbane, aktivitetet rekreative në zonat bregdetare dhe mangësitë strukturore në sistemet e menaxhimit të mbetjeve.

2.3.1 Rrugët e transportit të mbetjeve plastike

Gjatë periudhave me reshje të dendura ose me prurje të rritura lumore, mbetjet e grumbulluara nga vendbanimet në brendësi të territorit mund të mobilizohen dhe të transportohen në drejtim të rrjedhës së poshtme, drejt Detit Adriatik. Artikujt plastikë me peshë të lehtë, si qeset, materialet e ambalazhimit dhe shishet, janë veçanërisht të prirur të transportohen në distanca të gjata përmes sistemeve lumore.



Si rezultat, zonat bregdetare pranë grykëderdhjes së Lumit Ishëm dhe plazhet përreth mund të funksionojnë si zona akumulimi, ku mbetjet e transportuara depozitohen nën ndikimin e rrjedhës lumore dhe rrymave bregdetare.

2.3.2 Turizmi dhe rekreacioni bregdetar

Plazhe si Hamallaj janë të ekspozuara ndaj një presioni të lartë rekreativ sezonal, veçanërisht gjatë muajve të verës, për shkak të aksesit të lehtë nga zona metropolitane Tiranë–Durrës dhe përqendrimit të vizitorëve ditorë dhe aktiviteteve të kohës së lirë në bregdet. Nëse infrastruktura e përshtatshme për grumbullimin e mbetjeve mungon, ose nëse vizitorët nuk i depozitojnë mbetjet në mënyrën e duhur, këto materiale mund të mbeten në plazhe dhe në zonat bregdetare përreth. Më pas, era, valët dhe lëvizjet e baticës dhe zbatës mund t'i transportojnë mbetjet drejt mjedisit detar, ku ato mund të grumbullohen përgjatë vijës bregdetare ose të shpërbëhen në fragmente më të vogla.

2.3.3 Rrjedhja e mbetjeve urbane dhe rrjedhjet sipërfaqësore

Rrjetet e kullimit urban dhe rrjedhjet sipërfaqësore gjatë reshjeve mund të transportojnë mbetje të lehta nga rrugët, zonat e ndërtimit dhe venddepozitimet e hapura drejt përrrenjve dhe degëve ujore pranë tyre, të cilat ushqejnë Lumin Ishëm. Me kalimin e kohës, këto materiale transportohen përgjatë rrjedhës së lumit dhe përfundimisht arrijnë në zonat bregdetare.

2.3.4 Mangësitë në menaxhimin e mbetjeve

Pavarësisht përmirësimeve në kuadrin e menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri gjatë viteve të fundit, sfida strukturore mbeten ende në grumbullimin, ndarjen dhe riciklimin e mbetjeve bashkiake. Infrastruktura e kufizuar e riciklimit, mbulimi jo i plotë me shërbim grumbullimi në disa zona dhe zbatimi i pamjaftueshëm i rregulloreve mjedisore rrisin mundësinë që mbetjet plastike t'i shpëtojnë sistemit formal të menaxhimit dhe të përfundojnë në mjedis.

Së bashku, këta faktorë krijojnë një rrugë përmes së cilës mbetjet plastike të gjeneruara brenda Basenit të Lumit Ishëm transportohen nga vendbanimet në brendësi të territorit drejt Detit Adriatik, duke kontribuar në akumulimin e mbetjeve detare përgjatë vijës bregdetare të Shqipërisë.

3. Kuadri i politikave për menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri dhe rëndësia për Basenin e Lumit Ishëm

3.1 Kuadri ligjor kombëtar për menaxhimin e mbetjeve

Shqipëria ka forcuar kuadrin e saj ligjor për menaxhimin e mbetjeve, si pjesë e procesit të përafrimit me acquis të Bashkimit Evropian dhe të tranzicionit drejt një ekonomie më qarkulluese dhe më efikase në përdorimin e burimeve. Baza kryesore ligjore është Ligji Nr. 57/2025 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, i cili përcakton parimet kryesore për parandalimin e mbetjeve, grumbullimin e diferencuar, trajtimin, rikuperimin, asgjësimin, planifikimin, monitorimin dhe kontrollin. Ligji synon të përafrojë kuadrin kombëtar me



Direktivën Kuadër të BE-së për Mbetjet 2008/98/KE dhe mbështetet në hierarkinë e mbetjeve, e cila i jep përparësi parandalimit, ripërdorimit dhe riciklimit ndaj rikuperimit dhe depozitimit në landfill.

Një zhvillim i rëndësishëm i kohëve të fundit është Ligji Nr. 74/2025, datë 4 dhjetor 2025, “Për Përgjegjësitë e Zgjeruara të Prodhuesve të Produkteve që Gjenerojnë Mbetje”, i cili krijon bazën ligjore për zbatimin e Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit në Shqipëri. Ky ligj parashikon përgjegjësinë e prodhuesve për fazën pas konsumit të rrjedhave përkatëse të mbetjeve dhe synon të mbështesë grumbullimin, rikthimin, trajtimin, raportimin dhe mekanizmat e financimit për produktet që kthehen në mbetje, përfshirë ambalazhet. Në aspektin e politikave, ky përbën një hap të rëndësishëm, pasi zhvendos një pjesë të barrës financiare dhe organizative të menaxhimit të mbetjeve nga bashkitë drejt prodhuesve dhe importuesve.

Ky kuadër plotësohet nga një sërë aktesh nënligjore që rregullojnë aspekte specifike të zbatimit. Përveç kësaj, projekt-Plani Kombëtar për Parandalimin e Mbetjeve është publikuar për konsultim publik dhe është i rëndësishëm në këtë kontekst, pasi e trajton parandalimin e mbetjeve, përfshirë parandalimin e mbetjeve plastike, si një prioritet të politikave publike dhe identifikon masa që mund të mbështesin zbatimin në nivel kombëtar dhe vendor.

Kuadri mbështetet gjithashtu nga Programi Kombëtar për Parandalimin e Mbetjeve, i cili është hapur për konsultim publik dhe forcon më tej rëndësinë e reduktimit të gjenerimit të mbetjeve në burim. Programi evidenton rrjedha prioritare të mbetjeve, si plastikat dhe ambalazhet, dhe është veçanërisht i rëndësishëm pasi përcakton masa që mund të mbështesin zbatimin në nivel kombëtar dhe vendor, duke përfshirë veprime për nxitjen e ripërdorimit, riparimit, konsumit të qëndrueshëm dhe praktikave më të gjera të parandalimit të mbetjeve.

- VKM Nr. 232, datë 26.04.2018, i cili ndryshoi Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 177, datë 06.03.2012, “Për ambalazhet dhe mbetjet e tyre”, forcoi bazën rregullatore për menaxhimin e mbetjeve nga ambalazhet.
- Vendimi Nr. 319, datë 31.05.2018, “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve”, përcaktoi masa që lidhen me financimin dhe mbulimin e kostove të shërbimeve të menaxhimit të integruar të mbetjeve.
- Përveç kësaj, VKM Nr. 687, datë 29.07.2015, “Për miratimin e rregullave për mbajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave për mbetjet”, përcakton kuadrin për mbledhjen, përditësimin dhe publikimin e të dhënave mbi mbetjet, duke mbështetur kështu monitorimin, raportimin dhe zbatimin e politikave të bazuara në evidenca.

3.2 Kuadri strategjik i politikave

Në vitin 2020, Shqipëria miratoi dy dokumente të rëndësishme strategjike për orientimin e përpjekjeve në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve. Këto përfshijnë “Dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planin Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” për



periudhën 2020–2035, si dhe “Planin Kombëtar Sektorial për Menaxhimin e Mbetjeve”/ Masterplanin. Këto dokumente përcaktojnë vizionin afatgjatë të vendit dhe masat konkrete për përmirësimin e infrastrukturës dhe praktikave të menaxhimit të mbetjeve, duke synuar përafrimin me politikat e Bashkimit Evropian dhe promovimin e zgjidhjeve të qëndrueshme për menaxhimin e mbetjeve.

Strategjia u miratua me VKM Nr. 418/2020 dhe zbatimi i saj filloi në vitin 2021. Ajo përcakton drejtimin afatgjatë për përmirësimin e grumbullimit, trajtimit, rikuperimit dhe parandalimit të mbetjeve, si dhe shërben si instrumenti kryesor i planifikimit për reformën në sektorin e menaxhimit të mbetjeve.

Strategjia përcakton objektiva kombëtare për:

- zgjerimin e mbulimit me shërbim të grumbullimit të mbetjeve bashkiake;
- rritjen e normave të riciklimit dhe rikuperimit të materialeve;
- uljen e varësisë nga depozitimi në landfill;
- forcimin e kapaciteteve institucionale dhe koordinimit në sektorin e menaxhimit të mbetjeve

Dokumenti i Politikave Strategjike dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, së bashku me Masterplanin, kanë parashikuar ndarjen e të gjithë territorit të Shqipërisë në 10 zona të menaxhimit të mbetjeve, të cilat përbëjnë njësitë bazë për planifikimin e menaxhimit të integruar të mbetjeve. Këto zona shërbejnë si njësi themelore për organizimin më efikas dhe më të lokalizuar të menaxhimit të mbetjeve në nivel vendi.

Sipas Masterplanit, Baseni i Lumit Ishëm përfshihet në Zonën e Mbetjeve Tiranë–Durrës. Zbatimi i Dokumentit të Politikave Strategjike dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, si dhe i Masterplanit, kërkon hartimin e planeve për secilën Zonë Mbetjesh të përcaktuar në vend, duke përfshirë mënyrën e trajtimit dhe destinacionin përfundimtar të mbetjeve, në përputhje me Direktivën 2008/98/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 19 nëntor 2008, “Për mbetjet dhe shfuqizimin e disa direktivave”. Kjo direktivë përcakton kuadrin për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve dhe synon që praktikën e menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri të përafrohen me standardet e Bashkimit Evropian, me fokus në reduktimin, riciklimin dhe asgjësimin e sigurt të mbetjeve.

Shqipëria ka përfshirë gjithashtu objektiva të ekonomisë qarkulluese në kuadrin e politikave të saj për menaxhimin e mbetjeve. Udhërrëfyshi i OECD-së për Ekonominë Qarkulluese në Shqipëri identifikon plastikën, mbetjet detare, mbetjet bashkiake, instrumentet ekonomike dhe koordinimin ndër-institucional si fusha prioritare për reformë. Udhërrëfyshi thekson gjithashtu se Shqipëria ka ndryshuar kuadrin e saj ligjor për mbetjet në vitin 2022, duke ndaluar disa kategori qesesh plastike, por përafrimi me rregullat e Bashkimit Evropian për produktet plastike njëpërdorimshe mbetet ende i pjesshëm dhe kërkon përafrim të mëtejshëm.

3.3 Përgjegjësitë institucionale për menaxhimin e mbetjeve

Menaxhimi i mbetjeve në Shqipëri përfshin një strukturë qeverisjeje me disa nivele, ku përfshihen si institucionet qendrore, ashtu edhe ato vendore.

- Në nivel qendror, Ministria e Mjedisit është përgjegjëse për hartimin e politikave kombëtare dhe legjislacionit që lidhet me menaxhimin e mbetjeve dhe mbrojtjen e mjedisit. Ministria koordinon gjithashtu zbatimin e strategjive mjedisore dhe siguron përafrimin e tyre me standardet e Bashkimit Evropian.
- Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve (AKEM) luan një rol të rëndësishëm koordinues dhe monitorues në menaxhimin e integruar të mbetjeve. E krijuar në vitin 2024, agjencia mbështet planifikimin, menaxhimin e të dhënave, koordinimin ndërinstitutional dhe zbatimin e hierarkisë së mbetjeve në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore. Në këtë kontekst politikash, AKEM duhet të kuptohet kryesisht si një institucion publik koordinues dhe mbikëqyrës, dhe jo si operator i drejtpërdrejtë i shërbimeve të trajtimit të mbetjeve në çdo basen.
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) është përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave mjedisore, administrimin e sistemeve të informacionit mjedisor, si dhe mbështetjen e proceseve të monitorimit dhe raportimit mjedisor.
- Në nivel vendor, bashkitë janë aktorët kryesorë përgjegjës për zbatimin e politikave të menaxhimit të mbetjeve. Përgjegjësitë e tyre përfshijnë organizimin e shërbimeve të grumbullimit të mbetjeve bashkiake, hartimin e planeve vendore për menaxhimin e mbetjeve, administrimin e infrastrukturës lokale të mbetjeve dhe sigurimin e përputhshmërisë me rregulloret mjedisore.

3.4 Mangësitë kryesore të zbatimit në Basenin e Lumit Ishëm

Pavarësisht ekzistencës së një kuadri ligjor dhe strategjik kombëtar për menaxhimin e mbetjeve dhe ndotjen plastike, evidencat nga monitorimi tregojnë se sasi të konsiderueshme mbetjesh plastike vazhdojnë të arrijnë në mjedisin detar nga Baseni i Lumit Ishëm.

Dominimi i vazhdueshëm i ambalazheve të konsumit dhe i mbetjeve të lidhura me pijet në zonat bregdetare tregon se masat ekzistuese të politikave nuk janë përkthyer ende në rezultate mjaftueshëm efektive në nivel zbatimi.

- Një nga mangësitë kryesore lidhet me **mbulimin e pabarabartë dhe qëndrueshmërinë e kufizuar të shërbimeve të grumbullimit të mbetjeve bashkiake**, veçanërisht në zonat peri-urbane dhe në vendbanimet që po zgjerohen me ritme të shpejta. Aty ku sistemet e grumbullimit dhe infrastruktura përkatëse mbeten të pamjaftueshme, mbetjet kanë më shumë gjasa të hidhen në hapësira të hapura, kanale kulluese dhe pranë trupave ujorë, duke rritur mundësinë e transportit të tyre përgjatë rrjedhës drejt zonave bregdetare.
- Një dobësi e dytë është **zhvillimi i kufizuar i sistemeve të grumbullimit të diferencuar dhe riciklimit**. Në shumë bashki, materialet e riciklueshme vazhdojnë të menaxhohen brenda

rrjedhave të përziera të mbetjeve, duke ulur normat e rikuperimit dhe duke rritur rrezikun që ambalazhet plastike të përfundojnë në mjedis.

- Një tjetër mangësi në zbatim lidhet me **masat për kontrollin e ambalazheve plastike**, duke përfshirë kufizimet për qeset plastike, Përgjegjësinë e Zgjeruar të Prodhuesit dhe mekanizma të tjerë rikuperimi. Megjithatë Shqipëria ka krijuar bazën ligjore përkatëse, zbatimi mbetet ende i paplotë, ndërsa artikuj të zakonshëm të mbetjeve, si enët e pijeve dhe ambalazhet e lehta, ende nuk po kapen në mënyrë efektive nga sistemet ekzistuese.
- Presioni **sezonal rekreativ në zonat bregdetare** e shton më tej këtë sfidë, veçanërisht aty ku koshat e mbetjeve, shërbimet e grumbullimit dhe masat e ndërgjegjësimit publik janë të pamjaftueshme gjatë periudhave të pikut turistik. Kjo rrit mundësinë e hedhjes së drejtpërdrejtë të mbetjeve dhe të akumulimit të ambalazheve njëpërdorimshe në mjediset e plazhit.
- Në të njëjtën kohë, disa **kufizime ndërsektoriale** vazhdojnë të ndikojnë në efektivitetin e politikave. Këto përfshijnë kapacitetet e dobëta të inspektimit në nivel vendor, monitorimin e kufizuar të pikave kritike të rrjedhjes së mbetjeve dhe praktikave informale të depozitimit, si dhe nivelin e ulët të ndërgjegjësimit publik mbi ndikimet mjedisore të hedhjes së mbetjeve në mjedis. Së bashku, këta faktorë ulin efektivitetin praktik të masave ekzistuese.
- Ekziston gjithashtu një **boshllëk më i gjerë qeverisës ndërmjet menaxhimit të mbetjeve dhe menaxhimit të baseneve lumore**. Në kontekstin e Ishmit, ndotja plastike nuk është vetëm një çështje e menaxhimit të mbetjeve bashkiake, por edhe një çështje e sistemit lumor, pasi rrjedhat ujore shërbejnë si një rrugë kryesore përmes së cilës mbetjet me origjinë tokësore arrijnë në bregdet. Megjithatë, kjo lidhje ndërmjet pjesës së sipërme dhe të poshtme të basenit ende nuk reflektohet mjaftueshëm në zbatimin e politikave dhe në koordinimin institucional.

Në përfundim, sfida kryesore në Basenin e Lumit Ishëm nuk qëndron te mungesa e legjislacionit, por te efektiviteti i kufizuar i zbatimit të tij. Për këtë arsye, përpjekjet e politikave duhet të fokusohen në përmirësimin e mbulimit me shërbim grumbullimi në zonat peri-urbane, forcimin e sistemeve të grumbullimit të diferencuar dhe rikuperimit të ambalazheve, rritjen e kapaciteteve të zbatimit, inspektimit dhe monitorimit, përmirësimin e bazës së evidencave mbi performancën e menaxhimit të mbetjeve në nivel baseni, si dhe integrimin më efektiv të menaxhimit të mbetjeve në përgjigjet ndaj ndotjes lumore dhe bregdetare.

4. Rekomandime për politikat

Situata aktuale në Basenin e Lumit Ishëm karakterizohet nga presion i lartë mjedisor, i nxitur nga përqendrimi i popullsisë dhe aktivitetit ekonomik në korridorin Tiranë–Durrës, i kombinuar me dobësi të vazhdueshme në infrastrukturën e ujërave të ndotura dhe të menaxhimit të mbetjeve. Sipas Censurit 2023, rreth 31.6%⁶ e popullsisë së Shqipërisë jeton në

⁶ <https://www.instat.gov.al/media/13626/cens-2023-census-botim.pdf>



Qarkun e Tiranës, ndërsa Qarku i Durrësit ka një dendësi popullore prej 296.2 banorë/km². Këto tregues evidentojnë një bazë të fortë presioni urban dhe peri-urban brenda basenit. Në të njëjtën kohë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit e klasifikon basenin Ishëm–Erzen në Klasën V në Raportin e Gjendjes së Mjedisit 2024⁸, çka tregon cilësi shumë të dobët të ujit. Plani i Menaxhimit të Basenit Ujor të Ishmit⁹ identifikon si presione kryesore ndotjen nga burimet pikësore të shkaktuara nga ujërat e ndotura urbane, ndotjen difuze të lidhur me bujqësinë, ndryshimet hidromorfologjike të trupave ujorë dhe shfrytëzimin e ujërave nëntokësore. Plani evidenton gjithashtu mangësi të rëndësishme infrastrukturore në basen, përfshirë vendbanime ku ujërat e ndotura shkarkohen pa trajtim, si dhe sisteme të kombinuara kanalizimesh që përziejnë ujërat e ndotura urbane me ujërat e reshjeve. Kjo rrit mundësinë e transportit të ndotësve drejt lumenjve. Në këtë kontekst, rrjedhja e mbetjeve plastike duhet të kuptohet si pjesë e një modeli më të gjerë presionesh kumulative, ku dendësia e lartë e vendbanimeve, mbulimi i pamjaftueshëm me shërbime, rrugët e transportit përmes ujërave të reshjeve dhe rrjedhat lumore kontribuojnë së bashku në lëvizjen e mbetjeve nga zonat e brendshme drejt bregdetit.

Evidenca shtesë nga burime ndërkombëtare dhe projekte të kohëve të fundit tregojnë gjithashtu për presione strukturore mbi Basenin e Lumit Ishëm. Raportimet e UNECE-së për menaxhimin e ujërave theksojnë se Shqipëria ende përballlet me mangësi të rëndësishme në monitorimin e gjendjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Në të njëjtën kohë, infrastruktura e ujërave të ndotura mbetet e pamjaftueshme, me vetëm 10 impiante të trajtimit të ujërave të ndotura në funksionim në nivel kombëtar dhe 114 të planifikuara deri në vitin 2050¹⁰, që kërkojnë investime në vlerën rreth 2.3 miliardë euro. Paralelisht, projekti AMORE-AL¹¹, “Vlerësimi i shkarkimeve të ndotësve për mbështetjen e menaxhimit të baseneve lumore në Shqipëri në përputhje me Direktivën Kuadër të BE-së për Ujërat”, një partneritet ndërmjet Austrisë dhe Shqipërisë, ka përzgjedhur Basenin e Ishmit si zonë pilot. Projekti e identifikon këtë basen si një zonë me nivel të lartë ndotjeje, ku rrugët e shkarkimeve nga burime pikësore dhe difuze kërkojnë vlerësim më të mirë. Së bashku, këto gjetje sugjerojnë se situata aktuale në Basenin e Ishmit nuk formësohet vetëm nga rrjedhja e mbetjeve të ngurta, por edhe nga mangësi më të gjera në infrastrukturë, monitorim dhe menaxhimin e ndotësve, të cilat përforcojnë presionin kumulativ mbi mjedisin.

Rekomandimet e politikave të paraqitura më poshtë i përgjigjen drejtpërdrejt profilit aktual të presioneve në Basenin e Lumit Ishëm. Masat prioritare bazohen në tre konsiderata kryesore: kategoritë dominuese të mbetjeve të identifikuara përmes monitorimit, rrugët kryesore të rrjedhjes së mbetjeve nga vendbanimet në brendësi të territorit drejt bregdetit, si dhe mundësia e zbatimit të masave brenda kuadrit aktual ligjor dhe institucional. Përparësi duhet t’u jepet masave që mund të reduktojnë rrjedhjen e mbetjeve në afat të shkurtër, duke mbështetur njëkohësisht përmirësime strukturore afatgjata në rikuperimin e ambalazheve, riciklimin dhe qeverisjen e sektorit.

⁷ <https://www.instat.gov.al/media/14330/cens-2023-durresi.pdf>

⁸ https://akm.gov.al/ova_doc/raporti-per-gjendjen-e-mjedisit-2024/

⁹ https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_606_PMBU_Ishem.pdf

¹⁰ https://unece.org/sites/default/files/2025-10/Albania_summary_report_6th_cycle_7Apr25_ENG.pdf

¹¹ https://oead.at/fileadmin/Dokumente/appear.at/projects/fact_sheets/APPEAR_Project320_fact_sheet_web.pdf

4.1 Masat prioritare për reduktimin e ndotjes plastike në Basenin e Lumit Ishëm

Masa prioritare	Ligji/akti përkatës	Kategoria kryesore e mbetjeve që adresohet	Institucionet/aktorët përgjegjës	Masat kryesore të zbatimit	Ndikimi i pritshëm
Forcimi i zbatimit të kufizimeve për qeset plastike dhe produktet plastike njëpërdorimshme	Ligji Nr. 57/2025; Ligji Nr. 74/2025; aktet nënligjore përkatëse për qeset plastike dhe mbetjet nga ambalazhet	Qeset plastike mbajtëse dhe artikuj të tjerë plastikë të lehtë	Ministria e Mjedisit; AKM; Inspektorati Mjedisor/Agjencitë Rajonale të Mjedisit; Autoriteti i Mbikëqyrjes së Tregut; bashkitë në Basenin e Lumit Ishëm; Agjencia/Këshilli i Basenit Ujor	1. Rritja e inspektimeve të shitësit me pakicë, shumicë dhe shpërndarësit, veçanërisht në tregjet urbane, zonat bregdetare dhe zonat tregtare me frekuentim të lartë. 2. Forcimi i kontroleve mbi importin dhe prodhimin vendas të artikujve plastikë të kufizuar. 3. Përmirësimi i koordinimit ndërmjet inspektorateve, doganave, bashkive dhe institucioneve në nivel baseni për identifikimin e zonave ku plastikët e lehtë kanë më shumë gjasa të hyjnë në kanalet e kulluesve dhe rrjedhat ujore. 4. Promovimi i alternativave të ripërdorshme përmes fushatave të ndërgjegjësimit, komunikimit vendor dhe bashkëpunimit me bizneset.	Reduktimi i rrjedhjes së qeseve plastike dhe plastikave të tjera të lehta drejt sistemeve të kullimit, degëve ujore dhe trupave ujorë.
Krijimi i një sistemi kombëtar depozite-rikthimi për ambalazhet e pijeve	Ligji Nr. 74/2025 për Përgjegjësinë e Zgjeruar të Prodhuarit; aktet nënligjore për zbatimin e rikuperimit të ambalazheve të pijeve	Shishet plastike, kapakët/tapat dhe kanaçet metalike të pijeve	Ministria e Mjedisit; AKEM; prodhuesit e pijeve; shitësit me pakicë; bashkitë; Agjencia/Këshilli i Basenit Ujor	1. Prezantimi i një skeme kombëtare depozite-rikthimi për shishet plastike, kanaçet metalike dhe ambalazhet e tjera prioritare të pijeve. 2. Vendosija e pikave të rikthimit në supermarkete, njësi tregtare, zona të shërbimeve publike dhe vende të tjera me konsum të lartë. 3. Sigurimi i lidhjes së sistemit me infrastrukturën e ndarjes, transportit dhe riciklimit. 4. Në bashkitë me rëndësi për basenin, prioritetizimi i pikave të rikthimit pranë vendbanimeve afër lumenjve dhe pikave të nxehta bregdetare ku mbetjet nga ambalazhet e pijeve regjistrohen më shpesh.	Ulje e ndotjes nga ambalazhet e pijeve dhe rritje e normave të rikthimit, grumbullimit dhe riciklimit.

Masa prioritare	Ligji/akti përkatës	Kategoria kryesore e mbetjeve që adresohet	Institucionet/aktorët përgjegjës	Masat kryesore të zbatimit	Ndikimi i pritshëm
Funksionalizimi i Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit për mbetjet nga ambalazhet	Ligji Nr. 74/2025; aktet nënligjore përkatëse për mbetjet nga ambalazhet dhe skemat e përgjegjësisë së prodhuesit	Ambalazhet ushqimore, enët plastike dhe ambalazhet e përziera të konsumit	Ministria e Mjedisit; AKEM; prodhuesit dhe importuesit; organizatat e përgjegjësisë së prodhuesit; bashkitë; Agjencia/Këshilli i Basenit Ujor	1. Miratimi i rregullave të detajuara operacionale për zbatimin e Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit. 2. Krijimi i organizatave të përgjegjësisë së prodhuesit dhe përcaktimi i objektivave të qarta për rikuperimin dhe riciklimin e mbetjeve nga ambalazhet. 3. Sigurimi që financimi nga prodhuesit të mbështesë sistemet e grumbullimit, ndarjes dhe trajtimit të mbetjeve. 4. Vendosja e mekanizmave të koordinimit në mënyrë që bashkitë dhe institucionet në nivel baseni të mund të identifikojnë pikat kritike të rrjedhjes së ambalazheve dhe të përdorin evidencat nga monitorimi në procesin e zbatimit.	Përmirësim i rikuperimit të ambalazheve dhe reduktim i rrjedhjes së ambalazheve të konsumit drejt mjedisit.
Zgjerimi i shërbimeve të grumbullimit të mbetjeve në zonat peri-urbane dhe vendbanimet me rritje të shpejtë	Ligji Nr. 57/2025; instrumentet kombëtare dhe vendore të planifikimit për menaxhimin e mbetjeve	Mbetje plastike të përziera dhe ambalazhe familjare	Bashkitë në Basenin e Lumit Ishëm; operatorët e mbetjeve; AKEM; Agjencia/Këshilli i Basenit Ujor	1. Zgjerimi i shërbimeve të rregullta të grumbullimit të mbetjeve në vendbanimet e sapourbanizuara, peri-urbane dhe të pambuluara mjaftueshëm me shërbim, veçanërisht ato pranë degëve ujore, brigjeve të lumenjve dhe korridoreve të kullimit. 2. Përmirësimi i numrit, vendndodhjes dhe mirëmbajtjes së pikave të grumbullimit dhe kontejnerëve të mbetjeve. Identifikimi dhe mbyllja e venddepozitimeve informale që paraqesin rrezik të drejtpërdrejtë për trupat ujorë. 3. Institucionet në nivel baseni mund të mbështesin hartëzimin e zonave ku mbetjet e pamenaxhuara kanë më shumë gjasa të mobilizohen nga reshjet dhe rrjedhjet sipërfaqësore.	Reduktim i rrjedhjes së mbetjeve drejt degëve ujore, kanaleve kulluese dhe brigjeve të lumenjve.

Masa prioritare	Ligji/akti përkatës	Kategoria kryesore e mbetjeve që adresohet	Institucionet/aktorët përgjegjës	Masat kryesore të zbatimit	Ndikimi i pritshëm
Forcimi i sistemeve të grumbullimit të diferencuar dhe riciklimit	Ligji Nr. 57/2025; Ligji Nr. 74/2025; aktet nënligjore për grumbullimin e diferencuar dhe mbetjet nga ambalazhet	Ambalazhet plastike, shishet dhe enët plastike	Bashkitë; kompanitë e riciklimit; autoritetet kombëtare të mbetjeve; AKEM; Agjencia/Këshilli i Basenit Ujor	1. Prezantimi ose zgjerimi i sistemeve të grumbullimit të diferencuar për materialet e riciklueshme, duke filluar me rrjedhat plastike me volum të lartë, si shishet, enët plastike dhe ambalazhet ushqimore. 2. Përmirësimi i infrastrukturës së diferencuar dhe mbështetja e tregjeve lokale për rikuperimin dhe riciklimin e materialeve. 3. Përdorimi i të dhënave lokale të monitorimit për të prioritetizuar zonat ku mbetjet plastike të riciklueshme po dalin më shpesh jashtë sistemit dhe po përfundojnë në mjedis. 4. Forcimi i koordinimit ndërmjet bashkive dhe institucioneve të basenit, në mënyrë që masat parandaluese dhe të rikuperimit të reflektojnë rrugët specifike të rrjedhjes së mbetjeve në nivel baseni.	Përmirësim i performancës së riciklimit dhe ulje e rrezikut të rrjedhjes së plastikës nga rrjedhat e përziera të mbetjeve.
Forcimi i masave për kapjen e mbetjeve në sistemet e ujërave të reshjeve dhe kullimit	Ligji Nr. 57/2025; legjislacioni për menaxhimin e ujërave dhe kullimin; rregulloret vendore për infrastrukturën dhe mirëmbajtjen	Mbetje plastike urbane dhe ambalazhe të lehta	Bashkitë; ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Ministria e Mjedisit; Agjencia/Këshilli i Basenit Ujor; autoritetet e kullimit	1. Instalimi i pengesave për kapjen e mbetjeve, rrjetave mbajtëse ose pajisjeve të ngjashme në kanalet kulluese, daljet e ujërave të reshjeve dhe degë të përzgjedhura ujore. 2. Përmirësimi i mirëmbajtjes dhe pastrimit rutinë të sistemeve të ujërave të reshjeve, veçanërisht para dhe gjatë periudhave me reshje të dendura. 3. Identifikimi i pikave prioritare të rrjedhjes së mbetjeve pranë trupave ujorë, urave, tombinove dhe daljeve të kullimit urban. 4. Institucionet e basenit dhe të menaxhimit të ujërave duhet të mbështesin identifikimin e pikave të ndërhyrjes ku mbetjet transportohen rregullisht përgjatë rrjedhës.	Reduktim i transportit të mbetjeve plastike nga zonat urbane drejt lumenjve.

Masa prioritare	Ligji/akti përkatës	Kategoria kryesore e mbetjeve që adresohet	Institucionet/aktorët përgjegjës	Masat kryesore të zbatimit	Ndikimi i pritshëm
Reduktimi i rrjedhjes së mbetjeve nga zonat rekreative bregdetare	Ligji Nr. 57/2025; rregulloret për turizmin dhe shërbimet publike vendore; aktet përkatëse bashkiake	Ambalazhet e pijeve, ambalazhet ushqimore, gotat dhe mbetje të tjera nga konsumi në vend	Bashkitë; bizneset turistike; Ministria e Turizmit; Ministria e Mjedisit; organizatat e shoqërisë civile; Agjencia/Këshilli i Basenit Ujor	1. Vendosja e koshave të përshtatshëm për mbetje dhe riciklim në plazhe, shëtitore dhe zona të tjera rekreative. Përmirësimi i frekuencës së shërbimeve të grumbullimit gjatë sezonit turistik, për të shmangur tejmbushjen e koshave dhe shpërndarjen e mbetjeve. 2. Nxitja e alternativave të ripërdorshme në bare, restorante dhe struktura turistike në plazh. 3. Zbatimi i fushatave të synuara ndërgjegjësuere për vizitorët dhe bizneset. 4. Institucionet e basenit mund të ndihmojnë në lidhjen e gjetjeve të monitorimit të mbetjeve bregdetare me masat në pjesën e sipërme të basenit dhe me koordinimin sezonal në nivel baseni.	Reduced littering and lower accumulation of disposable packaging in beach areas
Forcimi i monitorimit, raportimit dhe pjesëmarrjes qytetare	Ligji Nr. 57/2025; VKM Nr. 687/2015 për statistikën e mbetjeve; kuadri për monitorimin dhe raportimin mjedisor	Të gjitha kategoritë kryesore të mbetjeve	AKM; bashkitë; universitetet; organizatat e shoqërisë civile; Agjencia/Këshilli i Basenit Ujor; ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve	1. Zgjerimi i mbulimit të monitorimit në brigjet e lumenjve, degët ujore, kanalet kulluese dhe zonat bregdetare të akumulimit. 2. Hartëzimi i pikave të nxehta të rrjedhjes së mbetjeve dhe integrimi i gjetjeve lokale në sistemet bashkiake, të basenit dhe kombëtare të raportimit. 3. Mbështetja e shkencës qytetare, aktiviteteve të pastrimit dhe fushatave të ndërgjegjësimi të lidhura me mbledhjen e evidencave. 4. Nxitja e shkëmbimit të rregullt të të dhënave ndërmjet bashkive, institucioneve të basenit dhe autoriteteve mjedisore, në mënyrë që masat e politikave të jenë më të targetuara dhe të ndiqen më mirë në kohë.	Evidencë më e mirë për forcimin e zbatimit dhe masa parandaluese më të targetuara.

4.2 Prioritetet e zbatimit

Në periudhë afatshkurtër, masat më efektive pritet të jenë ato që reduktojnë drejtpërdrejtë rrjedhjen e mbetjeve nga vendbanimet në brendësi të territorit drejt trupave ujorë, si dhe nga zonat rekreative drejt bregdetit. Këto masa përfshijnë zgjerimin e shërbimit të grumbullimit të mbetjeve në zonat peri-urbane, forcimin e masave për kapjen e mbetjeve në sistemet e ujërave të reshjeve dhe kullimit, përmirësimin e infrastrukturës së mbetjeve në plazhe gjatë periudhave të pikut turistik, si dhe forcimin e zbatimit të kufizimeve për qeset plastike dhe artikuj të ngjashëm.

Në periudhë afatmesëm, nevojiten reforma strukturore për të adresuar rrjedhat e mbetjeve nga ambalazhet, të cilat janë identifikuar më shpesh gjatë monitorimit. Në veçanti, funksionalizimi i Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit për ambalazhet dhe krijimi i një sistemi depozite-rikthimi për ambalazhet e pijeve do të ndihmonin në kapjen e artikujve me volum të lartë, si shishet, kapakët/tapat dhe ambalazhet e tjera të konsumit, përpara se ato të përfundojnë në mjedis.

Reduktimi i rrjedhjes së mbetjeve plastike në Basenin e Lumit Ishëm do të varet më pak nga miratimi i legjislacionit të ri dhe më shumë nga përmirësimi i zbatimit praktik të instrumenteve ekzistuese. Për këtë arsye, **objektivi kryesor i politikave duhet të jetë shndërrimi i kuadrit aktual ligjor dhe strategjik në reduktime të matshme të rrjedhjes së mbetjeve plastike nga vendbanimet në brendësi të territorit drejt bregdetit të Adriatikut.**

4.3 Mekanizmat e angazhimit të aktorëve të interesit

Aktorët e identifikuar për zbatimin e rekomandimeve të politikave në Basenin e Lumit Ishëm paraqiten si më poshtë:

- **Ministria e Mjedisit** – përgjegjëse për orientimin e politikave kombëtare, kuadrin ligjor, koordinimin ndërinstytucional dhe mbikëqyrjen e zbatimit.
- **Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)** – përgjegjëse për monitorimin mjedisor, mbledhjen e të dhënave, raportimin dhe mbështetjen e zbatimit të bazuar në evidenca.
- **Inspektorati Mjedisor / Agjencia Rajonale e Mjedisit** – përgjegjës për inspektimet, zbatimin e ligjit dhe kontrollin e përputhshmërisë me legjislacionin mjedisor.
- **Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve (AKEM)** – përgjegjëse për koordinimin, monitorimin dhe mbështetjen e zbatimit të politikave dhe sistemeve të menaxhimit të integruar të mbetjeve.
- **Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore / Këshilli i Basenit Ujor** – përgjegjës për koordinimin në nivel baseni, integrimin e masave që lidhen me mbetjet në menaxhimin e basenit lumor, si dhe identifikimin e pikave të ndotjes dhe të rrjedhjes së mbetjeve përgjatë trupave ujorë.
- **Bashkitë në Basenin e Lumit Ishëm** – përgjegjëse për shërbimet vendore të grumbullimit



të mbetjeve, planifikimin bashkiak të menaxhimit të mbetjeve, infrastrukturën lokale, ndërgjegjësimin publik dhe zbatimin e masave vendore të parandalimit.

- **Ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve dhe autoritetet/operatorët e kullimit** – përgjegjës për sistemet e ujërave të reshjeve, infrastrukturën e kullimit dhe pikat e ndërhyrjes ku mbetjet mund të transportohen drejt lumenjve.
- **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë** – relevante për infrastrukturën e kullimit dhe të ujërave, si dhe për koordinimin e masave që lidhen me rrjedhjet urbane sipërfaqësore dhe sistemet e ujërave të reshjeve.
- **Ministria e Turizmit** – relevante për reduktimin e rrjedhjes së mbetjeve nga plazhet, zonat rekreative dhe aktivitetet e lidhura me turizmin.
- **Autoriteti i Mbikëqyrjes së Tregut dhe autoritetet doganore** – përgjegjës për monitorimin e produkteve plastike të kufizuara, importeve dhe përputhshmërisë me detyrimet që lidhen me produktet.
- **Prodhuesit, importuesit dhe organizatat e përgjegjësisë së prodhuesit** – përgjegjës për zbatimin e Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit, përmbushjen e detyrimeve për rikuperimin e ambalazheve dhe financimin e sistemeve të grumbullimit dhe trajtimit.
- **Prodhuesit e pijeve, shitësit me pakicë dhe operatorët tregtarë** – aktorë kyç për zbatimin e sistemeve të depozitë-rikthimit, rikuperimin e ambalazheve dhe reduktimin e mbetjeve të lidhura me pijet.
- **Operatorët e mbetjeve dhe kompanitë e riciklimit** – përgjegjës për grumbullimin, transportin, ndarjen, riciklimin dhe rikuperimin e materialeve të mbetjeve.
- **Bizneset turistike, përfshirë hotelet, restorantet, baret dhe operatorët e plazheve** – relevante për reduktimin e plastikave njëpërdorimëshe dhe përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve në vend në zonat bregdetare.
- **Universitetet dhe institucionet kërkimore** – të rëndësishme për gjenerimin e të dhënave, mbështetjen e monitorimit, analizën e rrugëve të ndotjes dhe ofrimin e ekspertizës teknike për zbatimin e masave.
- **Organizatat e shoqërisë civile dhe grupet komunitare** – të rëndësishme për rritjen e ndërgjegjësimin, shkencën qytetare, monitorimin komunitar, aksionet e pastrimit dhe forcimin e llogaridhënies publike.
- **Qytetarët dhe komunitetet lokale** – aktorë thelbësorë për ndarjen e mbetjeve në burim, praktikat e përgjegjshme të depozitimit dhe pjesëmarrjen në përpjekjet për parandalim dhe monitorim.



Zbatimi efektiv i masave të propozuara do të kërkojë angazhim të strukturuar ndërmjet institucioneve publike, bashkive, aktorëve të sektorit privat, shoqërisë civile dhe komuniteteve lokale. **Në Basenin e Lumit Ishëm, angazhimi i aktorëve të interesit është veçanërisht i rëndësishëm, pasi rrjedhja e mbetjeve plastike ndodh në disa pika të sistemit, duke filluar nga gjenerimi dhe grumbullimi i mbetjeve urbane, deri te transporti përmes rrjedhave lumore dhe akumulimi në zonat bregdetare.**

- Një mekanizëm i parë duhet të jetë krijimi i një platforme koordinimi në nivel baseni, e ndërtuar mbi arkitekturën ekzistuese të qeverisjes së baseneve lumore. Kjo platformë duhet të bashkojë bashkitë Tiranë, Kamëz, Vorë, Krujë, Kurbin dhe Durrës, autoritetet dhe agjencitë përkatëse të basenit, ministrinë përgjegjëse për mjedisin, AKEM, AKM, autoritetet e ujësjellës-kanalizimeve dhe kullimit, si dhe institucionet përkatëse bregdetare. Platforma mund të mbështesë planifikimin e përbashkët, shkëmbimin e të dhënave, identifikimin e pikave kritike të rrjedhjes së mbetjeve dhe koordinimin e veprimeve prioritare në të gjithë basenin.
- Një mekanizëm i dytë duhet të fokusohet te sektori privat, veçanërisht te prodhuesit, importuesit, shitësit me pakicë, kompanitë e pijeve, bizneset turistike, përfshirë sektorin HoReCa, si dhe operatorët e mbetjeve. Angazhimi i tyre është thelbësor për zbatimin e Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit, masave për rikuperimin e ambalazheve, sistemeve të depozitë-rikthimit dhe reduktimin e plastikave njëpërdorimëshe në mjediset tregtare dhe rekreative. Konsultimi i rregullt me këta aktorë mund të ndihmojë gjithashtu në identifikimin e pengesave operacionale dhe në përmirësimin e përputhshmërisë me detyrimet ligjore..
- Një mekanizëm i tretë duhet të përfshijë organizatat e shoqërisë civile, universitetet dhe grupet komunitare në monitorim, ndërgjegjësim dhe veprime parandaluese në nivel vendor. Nismat e shkencës qytetare, programet e pastrimit të plazheve, fushatat në shkolla dhe raportimi nga komuniteti i pikave të hedhjes së paligjshme të mbetjeve mund të përmirësojnë disponueshmërinë e të dhënave, duke forcuar njëkohësisht ndjenjën e përgjegjësisë publike ndaj masave kundër ndotjes.
- Një mekanizëm i katërt duhet të synojë aktorët e turizmit bregdetar, përfshirë operatorët e plazheve, hotelet, restorantet dhe shoqatat vendore të turizmit. Marrëveshjet sezonale të bashkëpunimit mund të ndihmojnë në sigurimin e koshave të mbetjeve, infrastrukturës për grumbullimin e diferencuar, materialeve ndërgjegjësuere dhe masave për parandalimin e ndotjes gjatë periudhave me fluks të lartë vizitorësh.
- Së fundi, angazhimi i aktorëve të interesit duhet të mbështetet përmes mekanizmave të rregullt të shkëmbimit të informacionit dhe raportimit, duke përfshirë publikimin e rezultateve të monitorimit, përditësimet mbi progresin e bashkive dhe takimet periodike të rishikimit me shumë aktorë. Kjo do të përmirësonte transparencën, do të forconte llogaridhënien dhe do të ndihmonte që masat e politikave të përshtaten në bazë të rezultateve të zbatimit.

5. Përfundime

Duke i përkthyer rezultatet e monitorimit në masa praktike të politikave, ky dokument politikash ofron rekomandime të bazuara në evidenca për reduktimin e ndotjes plastike dhe përmirësimin e performancës së menaxhimit të mbetjeve në Shqipërinë Qendrore. Forcimi i zbatimit të politikave ekzistuese dhe rritja e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të interesit do të jenë thelbësore për mbrojtjen e integritetit ekologjik të Lumit Ishëm dhe të ekosistemeve bregdetare të Adriatikut.

Për të reduktuar në mënyrë efektive ndotjen plastike në Basenin e Lumit Ishëm dhe për të parandaluar rrjedhjen e mëtejshme të mbetjeve drejt Detit Adriatik, autoritetet kombëtare dhe vendore duhet të marrin në konsideratë këto masa prioritare:

- **Forcimi i zbatimit të kufizimeve për qeset plastike**

Të sigurohet zbatimi i qëndrueshëm i rregulloreve ekzistuese përmes rritjes së inspektimeve të shpërndarjes së pakicë dhe shpërndarësit, si dhe përmes përmirësimit të koordinimit ndërmjet inspektorateve mjedisore, autoriteteve të mbikëqyrjes së tregut dhe shërbimeve doganore

- **Përmirësimi i mbulimit me shërbim të grumbullimit të mbetjeve në vendbanimet peri-urbane**

Të zgjerohet shërbimi i grumbullimit të mbetjeve bashkiake në zonat urbane dhe peri-urbane me rritje të shpejtë brenda Basenit të Lumit Ishëm, veçanërisht në bashki si Tirana, Kamza, Vora dhe Kruja, ku gjenerimi i mbetjeve është më i lartë.

- **Përsheptimi i zbatimit të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuarit për mbetjet nga ambalazhet**

Të funksionalizohen sistemet e Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuarit dhe të krijohen organizatat e përgjegjësisë së prodhuarit, të cilat financojnë grumbullimin dhe riciklimin e materialeve të ambalazhit.

- **Krijimi i një sistemi kombëtar depozitë-rikthimi për ambalazhet e pijeve**

Të zbatohet një mekanizëm depozitë-rikthimi për shishet plastike dhe ambalazhet e tjera të pijeve, me qëllim rritjen e ndjeshme të normave të grumbullimit dhe reduktimin e mbetjeve në lumenj dhe në zonat bregdetare.

- **Përmirësimi i menaxhimit të kullimit urban dhe i rrjedhjes së mbetjeve nga brigjet e lumenjve**

Të instalohen sisteme për kapjen dhe ndalimin e mbetjeve në kanalet kulluese dhe degët ujore të lidhura me Lumit Ishëm, për të parandaluar transportin e mbetjeve plastike drejt mjedisit detar.

- **Nxitja e masave për reduktimin e plastikës në zonat rekreative bregdetare**

Të inkurajohen bashkitë dhe bizneset turistike që të reduktojnë përdorimin e plastikave njëpërdorimëshe, të prezantojnë alternativa të ripërdorshme dhe të përmirësojnë infrastrukturën e grumbullimit të mbetjeve në plazhe si Hamallaj dhe zona e Kepit të Rodonit.